



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE

RAPORTI PËRMBLEDHËS I AKREDITIMIT

PËR SHKOLLËN E MESME PROFESIONALE “NAZMI RUSHITI”, PESHKOPI

QERSHOR 2026

I. BAZA LIGJORE

Procesi i Akreditimit për ofruesit e arsimit dhe formimit profesional, mbështetet në Ligjin Nr. 15-2017 datë 16.02.2017 *“Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, në Urdhrin nr. 845, datë 3.7.2025 për miratimin e *“Rregullores për Standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të arsimit dhe formimit Profesional”* të Ministrisë Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), në rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe në urdhrin e brendshëm të AKAFPK-së me nr. 33, datë 23.07.2025 *“Për miratimin e udhëzuesit për procedurat e përzgjedhjes, organizimit dhe etikës profesionale të specialistëve si vlerësues të jashtëm në zbatim të procesit të akreditimit në institucionet ofruese të AFP-së”*.

II. KONTEKSTI I OFRUESIT

Histori e shkollës:

Shkolla e Mesme Profesionale “Nazmi Rushiti”, Peshkopi ndodhet në qytetin e Peshkopisë dhe është në varësi të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit. Ajo është themeluar në nëntor të vitit 1946 (si shkollë pilot), në vitin 1948 si shkollë pedagogjike, më pas me profil bujqësor dhe vitet e fundit si shkollë profesionale.

Aktualisht kjo shkollë ofron kualifikime profesionale me kohëzgjatje 2, 3 dhe 4 vjeçare të cilat ndjekin arsimin bazë. Qëllimi i saj është jo vetëm përgatitja e profesionistëve të aftë për tregun e punës, por edhe ofrimi i mundësisë për nxënësit që të vazhdojnë arsimin e lartë. Një pikë e fortë e kësaj shkolle ishte edhe rikonstruksioni i godinës në Peshkopi në vitin 2023. Falë këtij rikonstruksioni aktualisht ofrohen kushte bashkëkohore dhe gjithëpërfshirëse. Shkolla është e pajisur me laboratorë për çdo kualifikim profesional që ofrojnë, me rampa, ashensor dhe tualete për nxënësit me aftësi të veçanta në çdo kat të saj.

Shkolla e Mesme Profesionale “Nazmi Rushiti”, Peshkopi ofron aktualisht këto kualifikime profesionale si pas KSHK-së:

1. “Ekonomi-Biznes” Niveli II në KSHK; L-II-21
2. “Tregti” Niveli IV në KSHK; L6-IV-23
3. “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” Niveli II në KSHK; T-II-25
4. “Mbështetje e përdoruesve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit”, Niveli IV në KSHK; T2-IV-21
5. “Rrjete të Dhënash” Niveli IV në KSHK; T1-IV-21
6. “Zhvillim Website” Niveli IV në KSHK; T3-IV-21
7. “Hoteleri-Turizëm” Niveli II në KSHK; G-II-22
8. “Kuzhinë-Pastiçeri” Niveli III në KSHK; G2-III-22
9. “Hoteleri-Turizëm”, Niveli IV në KSHK; G-IV-25
10. “Shërbime Sociale dhe Shëndetësore” Niveli II në KSHK; O-II-22
11. “Shërbime Kujdesi për Fëmijë” Niveli III në KSHK; O2-III-24

12. "Shërbime Kujdesi për Moshuar" Niveli III në KSHK; O1-III-24
13. "Shërbime Sociale dhe Shëndetësore" Niveli IV në KSHK; O-IV-25
14. "Teknologji Ushqimore" Niveli II në KSHK; A-II-21
15. "Teknologji e përpunimit të qumështit", Niveli III në KSHK; A3-III-22
16. "Gjeologji-Miniera" Niveli II në KSHK; I-II-20
17. "Miniera" Niveli III në KSHK; I1-III-20
18. "Gjeologji-Miniera" Niveli IV në KSHK; I-IV-23

III. PËRMBLEDHJA E PROCESIT

Ofruesi Publik i AFP-së, Shkolla e Mesme Profesionale "Nazmi Rushiti", Peshkopi, depozitoi kërkesën për akreditim pranë AKAFPK-së me nr. 347 prot. datë 17.07.2025 "Kërkesë për Akreditim", protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 251 prot., më datë 21.07.2025. Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, në zbatim të Urdhrit nr. 845/2025 të MEKI nisi procesin e Akreditimit duke ngritur dhe konsoliduar grupin e vlerësuesve të jashtëm (GVJ), përmes një procedure të miratuar më parë.

GVJ, për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm të akreditimit të Shkollës së Mesme Profesionale "Nazmi Rushiti", Peshkopi me qëllim sigurimin e një analize të plotë dhe të saktë ka përdorur metoda dhe instrumente të ndryshme, si më poshtë:

Metodologjia e ndjekur për procesin e vlerësimit të jashtëm bazohet në një qasje sistematike dhe të strukturuar, në përputhje me fazat procedurale të përcaktuara në Urdhrin Nr. 845, datë 3.7.2025 "*Për miratimin e rregullores për standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional*". Procesi i vlerësimit u zhvillua në disa etapa të ndërlidhura, të cilat synuan mbledhjen dhe analizimin e evidencave për verifikimin e përmbushjes së standardeve të akreditimit.

Në fazën përpara vizitës në terren, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u njoh dhe shqyrtoi në mënyrë të detajuar dosjen e aplikimit për akreditim, raportin e vetëvlerësimit dhe dokumentacionin shoqërues të paraqitur nga institucioni. Ky proces analitik u zhvillua si paraprakisht, ashtu edhe gjatë fazave të mëvonshme të vlerësimit, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së dokumentacionit me kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë.

Në vijim të këtij procesi u zhvilluan mbledhje periodike të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, në format fizik dhe online, me qëllim koordinimin e punës së anëtarëve të grupit, ndarjen e detyrave sipas fushave të vlerësimit dhe qartësimin e çështjeve specifike që lidhen me kriteret e akreditimit. Si pjesë e procesit të mbledhjes së informacionit, u administruan *pyetësorë online përmes platformave digjitale për grupe të ndryshme të palëve të interesit*, si nxënësit dhe stafi mësimdhënës. Administrimi i këtyre instrumenteve synoi të mundësonte mbledhjen e të dhënave mbi perceptimin e aktorëve të përfshirë në procesin arsimor, si dhe të plotësonte informacionin e mbledhur nga burime të tjera të vlerësimit.

Në përputhje me kërkesat e procedurës së akreditimit, GVJ realizoi vizitën në terren në institucion, e cila u zhvillua për një periudhë prej tre ditësh, sipas planit të miratuar të vizitës. Gjatë kësaj periudhe u krye verifikimi i evidencave nëpërmjet ***vëzhgimit të drejtpërdrejtë të ambienteve mësimore dhe laboratorëve, analizimit të dokumentacionit institucional dhe zhvillimit të intervistave*** me aktorët kryesorë të institucionit.

Procesi i vizitës në terren përfshiu gjithashtu zhvillimin e intervistave dhe takimeve me drejtuesit e institucionit, me stafin mësimdhënës dhe me grupe nxënësish, si dhe fokus-grupe për të evidentuar mënyrën e funksionimit të proceseve mësimore dhe organizative.

Paralelisht me këto aktivitete, u kryen verifikime të dokumentacionit administrativ, mësimor dhe financiar, si dhe u realizuan vëzhgime të drejtpërdrejta të aktiviteteve mësimore dhe të mjediseve të institucionit.

Si pjesë e procesit të verifikimit të bashkëpunimit me tregun e punës, u realizuan edhe ***vizita në ambientet e partnerëve të biznesit*** që bashkëpunojnë me institucionin për zhvillimin e praktikave profesionale. Këto vizita shërbyen për të vlerësuar në terren organizimin dhe funksionimin e praktikave profesionale, si dhe nivelin e bashkëpunimit të institucionit me sektorin e biznesit.

Në përfundim të vizitës në terren, GVJ analizoi në mënyrë të integruar të gjitha të dhënat dhe evidencat e mbledhura nga dokumentacioni, ***vëzhgimet, intervistat dhe pyetësorët***, duke hartuar gjetjet dhe konkluzionet përkatëse mbi përmbushjen e standardeve të akreditimit. Raporti paraprak iu paraqit Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), së bashku me evidencat mbështetëse, dhe pas reflektimit të komenteve përkatëse u hartua dokumenti përfundimtar i raportit të vlerësimit.

IV. GJETJET PËR 5 FUSHAT E CILËSISË

Fusha 1 Menaxhimi.

Institucioni i AFP-së dëshmon një vullnet të qartë për të konsoliduar strukturat e tij drejtuese dhe për të formalizuar proceset e sigurimit të cilësisë, duke krijuar një bazë solide për bashkëpunimin e ardhshëm me grupet e interesit. Megjithatë dokumentimi i rregullt i takimeve me bizneset dhe prindërit është një hap pozitiv drejt transparencës, ekziston një potencial i madh i pashfrytëzuar për t'i shndërruar këto marrëdhënie në partneritete aktive konsultative që ndikojnë drejtpërdrejt në pasurimin e kurrikulës. Plani Afatmesëm i Zhvillimit dhe procesi i vetëvlerësimit shërbejnë si mjete premtuese për orientimin e shkollës. Ndërsa institucioni është i integruar me sukses në platformat kombëtare të të dhënave, fokusimi në aktivizimin e faqes zyrtare do të rriste ndjeshëm komunikimin dhe besueshmërinë publike. Megjithatë, një sfidë kritike që kërkon vëmendje të menjëhershme mbetet godina e Bulqizës; mungesa e investimeve kapitale, bllokimi i procedurave për shkak të statusit të pronësisë dhe amortizimi i godinës kanë krijuar një hendek të madh infrastrukturor. Adresimi i këtyre barrierave në Bulqizë është thelbësor për të garantuar që

standardet e cilësisë dhe sigurisë të jenë të njëtrajtshme në të gjitha njësitë e ofruesit, duke siguruar një mjedis nxënieje dinjtoz për të gjithë nxënësit.

Fusha 2 Marrëdhënia dhe bashkëpunimi.

Drejtoria e institucionit informon në mënyrë të rregullt institucionet qendrore dhe vendore për veprimtarinë dhe rezultatet e shkollës. Të dhënat mblidhen në mënyrë sistematike. Drejtoria ndërton partneritete zyrtare me bizneset vendase dhe mban evidenca mbi rezultatet dhe efektet e këtyre bashkëpunimeve. Gjithashtu, drejtoria dhe stafi zhvillojnë pyetësorë dhe anketime me grupet e interesit për të vlerësuar veprimtarinë dhe rezultatet e shkollës. Institucioni është aktiv në rrjetet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit dhe formimit profesional si dhe në projekte të përbashkëta të financuara në nivele të ndryshme, europian dhe ndërkombëtar.

Fusha 3 Kurrikula e zbatuar.

Ofruesi i AFP-së siguron zbatim të strukturuar të kurrikulës, duke planifikuar dhe përdorur burimet në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënësve dhe zhvillimit të kompetencave profesionale dhe kompetencave kyçe të nxënësve. Proces i mësimor mbështetet në dokumentacion dhe në përdorimin e materialeve didaktike dhe infrastrukturës përkatëse, megjithatë evidentohen nevojat për forcimin e planifikimit strategjik dhe afatgjatë të burimeve, rritjen e përdorimit të burimeve digjitale, si dhe përmirësimin e dokumentimit dhe lidhjes së kompetencave me rezultatet specifike të të nxënësve dhe kërkesat e tregut të punës.

Fusha 4 Mësimdhënia dhe të nxënësve.

Institucioni organizon dhe zbaton procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve në përputhje me kurrikulën e AFP-së dhe standardet e kualifikimeve profesionale, duke përdorur planifikime mësimore të strukturuar, metoda të ndryshme mësimore, forma të ndryshme vlerësimi dhe praktikë profesionale në bashkëpunim me bizneset dhe tregun e punës. Megjithatë, nevojitet forcimi i lidhjes ndërmjet aktiviteteve dhe rezultateve të të nxënësve, rritja e përdorimit të burimeve digjitale dhe metodave bashkëkohore të mësimdhënies, si dhe zhvillimi i mëtejshëm profesional i stafit pedagogjik për rritjen e cilësisë së procesit mësimor.

Fusha 5 Vlerësimi.

Mësimdhënësit përdorin metodologjitë dhe instrumentet e planifikuara për vlerësimin e vazhduar dhe përfundimtar, të cilat mbulojnë rezultatet e të nxënësve dhe kompetencat e përcaktuara në standarde. Të dhënat dhe evidencat për rezultatet e vlerësimit mblidhen dhe regjistrohen në mënyrë të rregullt. Planifikimi dhe organizimi i provimeve të niveleve dhe i Maturës Shtetërore Profesionale realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Drejtoria e institucionit siguron mjediset, infrastrukturën dhe burimet e nevojshme njerëzore dhe materiale për zhvillimin e provimeve. Rezultatet e vlerësimeve nuk publikohen në mjediset e institucionit, ndërsa institucioni zbaton edhe procedurat përkatëse të ankimimit.

V. REKOMANDIMET E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR

Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës vlerësuese tre-ditore pranë institucionit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton një performancë pozitive në përmbushjen e standardeve të AFP-së.

Me qëllim rritjen e cilësisë dhe konsolidimin e mëtejshëm të proceseve institucionale, GVJ rekomandon që kualifikimet profesionale, të cilat ofrohen në godinën e Bulqizës të transferohen në ambjentet fizike në Peshkopi, për vitin e ri shkollor 2026-2027, deri në përmirësimin e gjendjes dhe plotësimin e kërkesave. Kjo për arsye të mungesave të evidentuara në infrastrukturë, siguri dhe shëndet, kushte të domosdoshme për mirëqenien e nxënësve dhe mësimeve.

Gjithashtu në lidhje me kualifikimet profesionale, “Teknologji e përpunimit të qumështit”, Niveli III i KSHK-së dhe “Mbështetje e përdoruesve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit”, Niveli IV i KSHK-së, për të cilat aktualisht nuk ka nxënës, do të kryhet procesi i monitorimit individual nga ana e AKAFPK-së, në zbatim të urdhërit nr. 845, datë 3.7.2025, Neni 26, pika 2, gërma c).

FUSHA 1 MENAXHIMI:

Rekomandim 1 (Kriter bazë 1.1.1.1 & kriter plotësues 1.1.1.2)

Të sigurohet funksionimi dhe të përditësohet në mënyrë sistematike faqja zyrtare e institucionit, duke filluar nga ky vit shkollor (2025-2026), për të garantuar transparencën dhe pasqyrimin e kontributit të grupeve të interesit përmes publikimit të rregullt të aktiviteteve, vendimeve dhe dokumenteve kryesore.

Rekomandim 2 (Kriter bazë 1.1.1.3)

Të hartohet një kalendar vjetor për konsultimet me grupet e interesit, duke filluar nga viti shkollor 2026-2027 dhe të dokumentohen më qartë rekomandimet konkrete të dala nga këto konsultime.

Rekomandim 3 (Kriter bazë 1.2.1.1)

Institucioni duhet të rishikojë dhe përditësojë strukturën e Planit Afatmesëm të ardhshëm në mënyrë që të përputhet plotësisht me formatin dhe rubrikat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 759, datë 30.9.2024 i ndryshuar.

Rekomandim 4 (Kriter bazë 1.2.1.2 & kriter plotësues 1.2.1.3)

Institucioni duhet të marrë në konsideratë përfshirjen e rekomandimeve të grupeve të interesit në Planin Afatmesëm të ardhshëm, duke i reflektuar në mënyrë më të qartë në objektivat, veprimtaritë dhe treguesit e performancës.

Rekomandim 5 (Kriter bazë 1.2.2.1 & Kriter bazë 1.2.2.2)

Të forcohet procesi i monitorimit dhe raportimit të zbatimit të Planit Vjetor 2026-2027, përmes hartimit të raporteve periodike të realizimit të objektivave dhe analizës së treguesve të performancës.

Rekomandim 6 (Kriter bazë 1.3.1.1)

Të përmirësohet sistemi i arkivimit dhe administrimit digjital të dokumenteve zyrtare, me qëllim rritjen e efikasitetit operacional të institucionit deri në përfundim të vitit shkollor 2026-2027.

Rekomandim 7 (Kriter bazë 1.3.1.1)

Të realizohet trajnimi i punonjësit të arkiv-protokollit nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, me fokus standardizimin e formateve dhe protokollimin e dokumentacionit zyrtar, brenda vitit shkollor 2026-2027.

Rekomandim 8 (Kriter bazë 1.3.1.2)

Të hartohen udhëzuesat të brendshëm për administrimin e dokumenteve hyrëse/dalëse dhe të certifikimeve, duke standardizuar formatet dhe proceset në të gjitha platformat dhe sistemet e përdorura brenda vitit shkollor 2026-2027.

Rekomandim 9 (Kriter bazë 1.3.2.2)

Të përdoren rregullisht të dhënat nga anketat me të diplomuarit dhe partnerët, për të përmirësuar planet strategjike dhe programet mësimore të AFP-së, brenda vitit shkollor 2026-2027.

Rekomandimi 10 (Kriter bazë 1.4.1.4)

Të publikohet raporti i ardhshëm i vetëvlerësimit 2024-2025 në faqen zyrtare të ofruesit dhe në kanale të tjera mediatike brenda 2 javëve nga miratimi i tij.

Rekomandimi 11 ((Kriter bazë 1.4.2.3)

Të integrohen veprimtaritë e Planit të Përmirësimit të Cilësisë, në planin vjetor të ardhshëm 2026-2027 e në vijimësi.

Rekomandim 12 (Kriter bazë 1.5.1.2 & kriter plotësues 4.1.1.3)

Të sigurohet monitorimi i vazhdueshëm dhe ndarja e drejtë e ngarkesës së punës për të gjithë stafin, duke u bazuar në kapacitetet dhe nevojat e institucionit për vitin shkollor 2026-2027.

Rekomandim 13 (Kriter bazë 1.5.1.2)

Brenda vitit 2025-2026, të merren masa të menjëhershme për përditësimin e librezave të punës për të gjithë personelin (mësimdhënës dhe staf mbështetës).

Rekomandim 14 (Kriter bazë 1.5.1.5 & Kriter bazë 1.5.2.1)

Të identifikohen nevojat për trajnim përmes krahasimit të kualifikimeve aktuale me nevojat e shkollës për zhvillim profesional, duke siguruar realizimin, dokumentimin dhe monitorimin e reflektimit të tyre në procesin mësimor brenda vitit shkollor 2026-2027.

Rekomandim 15 (Kriter bazë 1.6.1.3 i papërbushur për godinën e Bulqizës)

Të kërkohet në institucionet përkatëse/projekte investime në përmirësimin e infrastrukturës fizike dhe blerjen e pajisjeve në godinën e Bulqizës brenda vitit shkollor 2026-2027.

Rekomandim 16 (Kriter bazë 1.6.2.2)

Të krijohet një sistem efektiv për monitorimin dhe dokumentimin e përdorimit të fondeve të alokuara duke vlerësuar rregullisht përputhshmërinë e shpenzimeve me prioritetet strategjike, duke filluar nga viti shkollor 2026-2027.

Rekomandim 17 (Kriter bazë i papërbushur për godinën e Bulqizës 1.6.3.1)

Të identifikohen dhe të ndiqen procedurat ligjore për rregullimin e statusit të pronësisë në

Bulqizë si parakusht për realizimin e investimeve kapitale dhe rehabilitimin e mjediseve mësimore e profesionale, brenda vitit shkollor 2026-2027.

Rekomandim 18 (Kriter bazë i papërbushur për godinën e Bulqizës 1.6.3.2)

Të garantohet plotësimi i mjediseve të praktikave profesionale me pajisjet e mbrojtjes kolektive dhe sinjalistikën e nevojshme të sigurisë, duke dokumentuar rregullisht inspektimet mbi gjendjen e tyre teknike brenda vitit shkollor 2026-2027.

Rekomandim 19 (Kriter bazë 1.6.3.4)

Të sigurohet mirëmbajtja e vazhdueshme dhe pajisja me bazë materiale e mjediseve higjieno-sanitare dhe hapësirave të përbashkëta, duke aplikuar një plan ditor pastrimi e dezinfektimi brenda vitit shkollor 2026-2027.

Rekomandim 20 (Kriter bazë 1.6.3.6)

Të planifikohen dhe të realizohen ndërhyrje infrastrukturore për përshtatjen e hyrjeve dhe mjediseve kryesore të shkollës për të mundësuar aksesin e papenguar të nxënësve me aftësi të kufizuara, brenda vitit shkollor 2026-2027.

Rekomandim 21 (Kriter plotësues i papërbushur për godinën e Bulqizës 1.6.3.7)

Të përshtatet një ambient ekzistues si bibliotekë/qendër informacioni në njësinë e Bulqizës, për të garantuar qasje të barabartë të nxënësve dhe mësimeve në materialet mësimore, brenda vitit shkollor 2026-2027.

Rekomandim 22 (Kriter bazë 1.6.4.2 dhe 1.6.5.1)

Brenda vitit shkollor 2026-2027, institucioni duhet të përmbushë të gjitha kërkesat ligjore për mbrojtjen nga zjarri në Bulqizë, duke kaluar nga masat minimale në një sistem të certifikuar dhe të sigurt për stafin dhe nxënësit.

Rekomandim 23 (Kriter bazë 1.7.1.3 & Kriter bazë 1.7.1.4)

Të implementohet një sistem digjital e transparent për menaxhimin e ankesave brenda vitit shkollor 2026-2027, i cili të garantojë mbrojtjen e të drejtave të nxënësve dhe stafit.

FUSHA 2 MARRËDHËNIA DHE BASHKËPUNIMI

Rekomandim 24 (Kriter bazë 2.2.1.4)

Të merret feedback nga bizneset partnere të shkollës nëpërmjet anketave të realizuara periodikisht si dhe të mbahen të dhëna për rezultatet e tyre lidhur me rezultatet e praktikave profesionale dhe aftësitë e nxënësve duke filluar nga viti shkollor 2026-2027 e në vijim.

Rekomandim 25 (Kriter bazë 2.2.2.1)

Të shtohen ambiente të specializuara në shkollë veçanërisht për kualifikimet profesionale Hoteleri-Turizëm, Teknologji Ushqimore që aktualisht realizojnë praktikën kryesisht në biznes duke filluar nga viti shkollor 2026-2027.

Rekomandimi 26 (Kriter plotësues 2.2.2.2)

Të promovohet zhvillimi i formës së arsimit të dyfishtë, në bashkëpunim me bizneset partnere dhe institucionet përgjegjëse, brenda vitit shkollor 2026-2027.

Rekomandim 27 (Kriter plotësues 2.3.1.3)

Të bashkëpunohet me organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetin lokal, me qëllim zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta që mbështesin orientimin në karrierë, promovimin e arsimit profesional dhe rritjen e regjistrimeve në institucion brenda vitit shkollor 2026-2027.

Rekomandim 28 (Kriter plotësues i papërbushur 2.4.2.3)

Drejtoria e ofruesit të AFP-së duhet të lidhë marrëveshjeve bashkëpunimi me ofruesit kombëtarë dhe ndërkombëtarë, të cilat përfshijnë praktika profesionale, trajnimin e stafit, shfrytëzimin e burimeve të përbashkëta brenda vitit shkollor 2026-2027.

FUSHA 3 KURRIKULA E ZBATUAR**Rekomandim 29 (Kriter bazë 3.1.1.2)**

Rekomandohet që institucioni të rishikojë të gjitha planet mësimore, lidhur me korrigjimin e pasaktësive në përmbajtje dhe strukturë, standardizimin e format, terminologjisë dhe saktësisë gjuhësore për vitin shkollor 2026-2027.

Rekomandim 30 (Kriter plotësues 3.1.4.1)

Rekomandohet që mësimdhënësit të përdorin të paktën 2 herë në vit instrumente vlerësimi për matjen e progresit të nxënësve, gjatë vitit shkollor 2026–2027 e në vijimësi.

Rekomandim 31 (Kriter bazë 3.2.1.1)

Gjatë vitit shkollor 2026 -2027 drejtoria e ofruesit të AFP-së duhet të kompletojë njësinë e Bulqizës me bazën e nevojshme materiale dhe didaktike për kualifikimet profesionale që ofron.

Rekomandim 32 (Kriter plotësues 3.2.1.2)

Të krijohet, brenda vitit shkollor 2026-2027, një sistem i qartë për monitorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve, me qëllim mbështetjen e procesit mësimor.

FUSHA 4 MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT**Rekomandim 33 (Kriter plotësues 4.1.1.3)**

Rekomandohet që institucioni, në përputhje me kërkesat pedagogjike dhe organizative të procesit mësimor, të sigurojë një shpërndarje më të ekuilibruar të moduleve dhe orëve të kulturës profesionale, duke përfshirë më shumë se një mësimdhënë të drejtimit përkatës, në vitin shkollor 2026-2027.

Rekomandim 34 (Kriter bazë i papërbushur për godinën e Bulqizës 4.1.2.2)

Për njësinë e Bulqizës, rekomandohet, që drejtoria të sigurojë dhe të pajisë mjediset mësimore me laboratorë funksionalë, mjete dhe pajisje praktike sipas drejtimeve (p.sh. instrumente matëse dhe modele për gjeologji/miniera, si dhe pajisje bazë për shërbime sociale-shëndetësore) brenda vitit shkollor 2026-2027.

Rekomandim 35 (Kriter bazë 4.1.2.2)

Rekomandohet lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimi me partnerë të biznesit ose institucione për sigurimin e mjediseve, pajisjeve dhe burimeve materiale të nevojshme për zhvillimin e praktikës profesionale, brenda 6 muajve.

Rekomandim 36 (Kriter plotësues 4.2.1.3)

Rekomandohet që Institucioni të organizojë dhe zbatojë projekte ndërkurrikulare të dokumentuara (raporte, prezantime, modele) gjatë vitit shkollor 2026-2027.

Rekomandim 37 (Kriter plotësues 4.3.1.1)

Gjatë vitit shkollor 2026–2027 dhe në vijim, drejtoria e institucionit të kryejë të paktën 2 monitorime në vit mbi dokumentimin dhe zbatimin të aktiviteteve ndërkurrikulare në procesin mësimor.

Rekomandim 38 (Kriter plotësues 4.4.1.1)

Rekomandohet që mësimdhënësit të rishikojnë në mënyrë të vazhdueshme objektivat, materialet dhe strategjitë mësimore, duke u mbështetur në rezultatet e vlerësimit dhe në reagimet e marra nga grupet e interesit, veçanërisht nga nxënësit dhe punëdhënësit, të paktën një herë në gjashtë muaj.

Rekomandim 39 (Kriter plotësues 4.3.1.2)

Të trajnohen mësimdhënësit në përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies (teknologjitë mësimore dhe format e mësimin të kombinuar) duke filluar nga viti shkollor 2026-2027.

Rekomandim 40 (Kriter plotësues 4.3.1.4)

Të përdoren instrumente të vlerësimit të të nxënësve social dhe emocional, përfshirë pyetësorë vetëvlerësimi të nxënësve, ditarë reflektimi dhe matje të progresit individual, gjatë vitit shkollor 2026-2027 dhe në vazhdimësi.

Rekomandim 41 (Kriter bazë 4.3.2.1)

Të sigurohen pajisjet e nevojshme të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për njësinë në Bulqizë brenda vitit shkollor 2026-2027.

Rekomandim 42 (Kriter plotësues 4.3.2.2)

Gjatë vitit shkollor 2026–2027 dhe në vijim, të përdoren burime digjitale (prezantime, video ose platforma online) në procesin e mësimdhënies.

Rekomandim 43 (Kriter plotësues 4.4.1.2)

Gjatë vitit shkollor 2026-2027, të përdoren rezultatet e vlerësimit të vazhduar dhe përfundimtar për të identifikuar nevojat e nxënësve duke planifikuar orë konsultimi mbështetëse.

Rekomandim 44 (Kriter bazë i papërmbytur për godinën e Bulqizës 4.5.1.1)

Gjatë vitit shkollor 2026-2027, institucioni duhet të sigurojë aksesueshmëri të plotë për nxënësit me nevoja të veçanta përmes ndërtimit të rampave dhe sigurimit të mobiljeve me përshtatje individuale.

Rekomandim 45 (Kriter plotësues 4.5.1.2)

Rekomandohet që, prej vitit shkollor 2026–2027, të gjitha materialet didaktike dhe digjitale të jenë të përshtatura sipas standardeve të aksesueshmërisë për nxënësit me aftësi të kufizuara.

FUSHA 5 VLERËSIMI

Rekomandime 46 (Kriter plotësues 5.1.1.5)

Të zgjerohet përdorimi i metodave alternative të vlerësimit, veçanërisht përmes projekteve praktike, portofolit të nxënësit dhe situatave të simuluar profesionale, me qëllim vlerësimin më të plotë të kompetencave të nxënësve duke filluar nga viti shkollor 2026-2027.

Rekomandime 47 (Kriter plotësues 5.1.1.7)

Të hartohen dhe zbatohen 3 instrumenta vlerësimi të bazuara në kompetenca, të përdorura nga të gjithë mësimdhënësit për të vlerësuar mbi 50% të nxënësve brenda vitit shkollor 2025-2026.

Rekomandime 48 (Kriter plotësues 5.1.1.8)

Të trajnohen mësimdhënësit lidhur me vlerësimin e bazuar në kompetenca të nxënësit dhe përdorimin e instrumenteve bashkëkohore të vlerësimit brenda vitit shkollor 2026-2027.

Rekomandim 49 (Kriter plotësues 5.1.4.2)

Rekomandohet që përbërja e komisioneve të vlerësimit për provimet e niveleve të dokumentohet në mënyrë të plotë, të saktë dhe të standardizuar në çdo procesverbal brenda vitit shkollor 2026-2027.

Rekomandim 50 (Kriter plotësues i papërbushur 5.1.4.3)

Rekomandohet që institucioni për vitin shkollor 2026-2027 e në vijim, të informojë punëdhënësit dhe bizneset partnere të praktikave profesionale, për rezultatet e provimeve përfundimtare të nxënësve.

Rekomandim 51 (Kriter plotësues i papërbushur 5.1.4.4)

Drejtoria e ofruesit të AFP-së duhet të aplikojë rregullisht pyetësorë për matjen e kënaqësisë të bizneseve për vitin shkollor 2026-2027 dhe në vijim.

VI. VENDIMI PËR AKREDITIM

Në bazë të raportit të akreditimit dhe propozimit të AKAFPK-së, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit mori vendimin për **akreditim** për ofruesin publik të AFP-së, Shkolla e Mesme Profesionale “Nazmi Rushiti”, Peshkopi me Vendim nr. 251, datë 22.06.2026.

AKAFPK ka lëshuar certifikatën e akreditimit, me nr. serie 33 data 26.06.2026, me afat vlefshmërie deri më 21.06.2030.